



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MJEDISIT

**PROGRAMI I TRANSPARENCËS
PËR MINISTRINË E TURIZMIT DHE MJEDISIT**

I. HYRJE

Në përputhje me nenin 7 të ligjit nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” është përgatitur programi i transparencës për Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit. Ky program përcakton kornizën ligjore të veprimtarisë së ministrisë në kuadër të ligjit nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”(LDI).

Ky program është një mënyrë konkrete përmes së cilës Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ndërton dhe rrit transparencën në punën e saj institucionale, nën garancinë e LDI-së. MM do të përditësojë herë pas here Programin e Transparencës, në përputhje me pikën 2 të nenit 5 të LDI-së.

Informacioni i bërë publik në këtë program, synon të bëjë transparencën e veprimtarisë së punës së Ministrisë e Turizmit dhe Mjedisit, nëpërmjet pasqyrit të detajuar të tij në faqen zyrtare www.turizmi.gov.al, si dhe në mjediset e pritjes së publikut. Programi i transparencës pasqyrohet në rubrika, tekste/përmbajtje, afat kohor për bërjen publike të tij, mënyrën e bërjes publike, si dhe strukturën përkatëse e cila prodhon ose administron dokumentin.

Programi i transparencës evidenton skemën e publikimit, e cila pasqyron menutë ku adresohet dokumenti në faqen zyrtare në internet. Përveç kësaj, çdo dokument është i aksesueshëm edhe në skemë.

Dokumentacioni i bërë publik, do të jetë i përditësuar në formë e përmbajtje. Faqja zyrtare e së Ministrisë e Turizmit dhe Mjedisit është ndërtuar në atë formë që mundëson informacion për publikun pa kërkesë në format lehtësisht të kuptueshëm. Në rubrikat e faqes zyrtare pasqyrohen edhe informacione që karakterizohen nga kufizime të identifikimit të të dhënave personale për shkak të ruajtjes së privatësisë së individëve/subjekteve të të dhënave, etj.

Skema e publikimit paraqitet nëpërmjet tabelës përmbledhëse të evidentuar në këtë program.

II. PARIME TË PËRGJITHSHME

Parimet kryesore në të cilat mbështetet Programi i Transparencës së Ministrisë e Turizmit dhe Mjedisit janë:

1. “E drejta për informim” është e drejtë Kushtetuese e parashikuar në nenin 23 të saj, e aksesueshme nga të gjithë pa asnjë përjashtim.
2. Prezumimi i publikimit maksimal të të dhënave: së Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ushtron funksione publike, për rrjedhojë informacioni që rrjedh nga veprimtaria e saj publikohet në përputhje me legjislacionin në fuqi.
3. Zbatimi korrekt i ligjit dhe dispozitave ligjore që rregullojnë në mënyrë të posaçme veprimtarinë e së Ministrisë e Turizmit dhe Mjedisit.
4. Informacioni përshtatet në gjuhë të qartë e të kuptueshme.
5. Organ mbikëqyrës i procedurave të informimit publik është Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.
6. Rishikimi i programit të transparencës bëhet sipas së njëjtës procedurë, përmes së cilës është bërë miratimi i tij.
7. Informacioni publik pa kërkesë do të jetë:
 - i plotë;
 - i saktë;
 - i përditësuar;
 - i thjeshtë në konsultim;
 - i kuptueshëm;
 - lehtësisht i aksesueshëm;
 - i pajtueshëm me dokumentet origjinale në posedim të autoritetit publik.

III. INFORMACIONI QË BËHET PUBLIK PA KËRKESË

Informacioni i lejuar për publikim është shprehimisht i parashikuar në nenin 7 të ligjit Nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”.

Në përputhje me këtë program transparence të miratuar, së Ministria e Turizmit dhe Mjedisit vendos në dispozicion të publikut në faqen e saj të internetit www.turizmi.gov.al dhe/ose në mjediset e pritjes së publikut, kategoritë e mëposhtme të informacionit:

- Strukturën organizative të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit;
- Tekstet e plota, të konventave që janë ratifikuar, të ligjeve, të akteve nënligjore, të kodeve të sjelljes, dokumente politikash, të manualit ose ndonjë dokument tjetër që ka lidhje me ushtrimin e funksioneve të tij dhe që prek publikun e gjerë;
- Informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, adresën postare dhe elektronike për depozitim të kërkesave për informim, si dhe procedurat e ankimit të vendimit përkatës;

- Të dhëna për vendndodhjen e zyrave të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, orarin e punës, emrin dhe kontaktet e koordinatorit për të drejtën e informimit;
- Të dhëna për arsimin, kualifikimet dhe pagat e funksionarëve, të cilët kanë detyrimin për deklarimin e pasurisë, sipas ligjit, strukturat e pagave për nëpunësit e tjerë, si dhe një përshkrim të procedurave të zgjedhjes, kompetencave dhe detyrave të funksionarëve të lartë të autoritetit publik dhe procedurën që ata ndjekin për të marrë vendime;
- Mekanizmat monitorues dhe të kontrollit që veprojnë mbi autoritetin publik, përfshirë planet strategjike të punës, raportet e auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose subjekte të tjera, si dhe dokumentet që përmbajnë tregues të performancës së autoritetit;
- Të dhëna për buxhetin dhe planin e shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara, si dhe çdo raport vjetor për zbatimin e buxhetit.
- Informacion për procedurat e prokurimit apo procedurat konkurruese të koncesionit/partneritetit publik privat, përkatësisht, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9643, datë 20.12.2006, “Për prokurimin publik”, dhe të ligjit nr. 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, që kryhen për llogari të autoritetit publik, duke përfshirë: listën e kontratave të lidhura, shumën e kontraktuar, palët kontraktuese dhe përshkrimin e shërbimeve apo mallrave të kontraktuara, informacionin për zbatimin dhe monitorimin e kontratave, si dhe udhëzues e politika të ndryshme;
- Informacion për shërbimet që autoriteti i jep publikut, përfshirë standardet për cilësinë e shërbimit, një përshkrim të procedurave për t’i përfutur ato, informacione dhe dokumente që kërkohen shpesh, si dhe çdo informacion tjetër që gjykohet i dobishëm nga Ministria e Mjedisit;
- Çdo mekanizëm dhe procedurë për bërjen e kërkesave dhe ankesave, në lidhje me veprimet ose mosveprimet e autoritetit publik, procedura, përmes së cilës personat e interesuar mund të paraqesin mendimet e tyre apo të ndikojnë në çfarëdo mënyre tjetër në hartimin e ligjeve, të politikave publike apo ushtrimin e funksioneve së Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, një përshkrim të thjeshtë të sistemit që përdor autoriteti publik për mbajtjen e dokumentacionit, të llojeve, formave të dokumenteve, si dhe të kategorive të informacionit që bëhet publik pa kërkesë;
- së Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, gjithashtu, krijon dhe arkivon një kopje digjitale të faqes zyrtare të tij në internet, të plotësuar me informacionin që kërkohet në programin e miratuar të transparencës, si dhe për metodat, mekanizmat dhe periodicitetin e publikimit të informacioneve publike, të cilat vihen në dispozicion të publikut pa kërkesë;
- Aktet që përmbajnë rregulla, norma apo kufizime të të drejtave dhe lirive themelore të individit, si dhe me efekt të drejtpërdrejtë për ta, bëhen publike me anë të afishimit apo postimit në faqen zyrtare të internetit, brenda 48 orëve prej miratimit të aktit nga së Ministria e Turizmit dhe Mjedisit.

Informacioni i publikuar sipas kësaj skeme, përditësohet sa herë ai ndryshon.

IV. INFORMACION MBI “PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE, TË KËRKESAVE E PROCEDURAVE, PËR INFORMIM DHE PËRFSHIRJEN E PUBLIKUT NË VENDIMARRJEN MJEDISORE”

Informimi i publikut gjatë procedurës paraprake të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, informimi, konsultimi dhe dëgjesa publike gjatë procedurës së thelluar të VNM-së, si dhe cdo informacion tjetër që lidhet me ceshtjet e mjedisit dhe që përbën interes të lartë publik, mund të gjendet në VKM-në Nr 247, datë 30.04.2014, që është e publikuar në faqen zyrtare të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit <http://mjedisi.gov.al/ligjet-dhe-aktet-nenligjore-2/>

V. TABELA PËRMBLEDHËSE E PROGRAMIT TË TRANSPARENCËS SË MINISTRISË SË MJEDISIT

Kategoritë e informacionit publik pa kërkesë	Baza ligjore	Dokument i/Përmbajtja	Afati kohor për publikim	Mënyra e publikimit	Struktura përgjegjëse
Përshkrim i strukturës organizative, funksioneve dhe detyrave të autoritetit publik.	Neni 7/1/a/d	<i>Struktura organizative e MM-së</i>	<i>Pas botimit në fletoren zyrtare</i>	www.turizmi.gov.al	<i>Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve; nëpunësi përgjegjës për IT-në;</i>
Akte ndërkombëtare, ligje; akte nën ligjore; dokument politikash; dhe çdo dokument tjetër për mjedisin.	Neni 7/1/b		<i>Pas botimit në fletoren zyrtare</i>	www.turizmi.gov.al	<i>Drejtoritë teknike, Koordinatori; nëpunësi përgjegjës për IT-në;</i>
Informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, adresën postare dhe elektronike për depozitimin e kërkesave për	Neni 7/1/c/g		<i>Pas miratimit nga titullari</i>	www.turizmi.gov.al	<i>Koordinatori për informimin;</i>

informim, si dhe procedurat e ankimit të vendimit përkatës.					
Të dhëna për vendndodhjen e zyrave të autoritetit publik, orarin e punës, emrin dhe kontaktet e koordinorit për të drejtën e informimit.	Neni7/1 /ç		Menjëherë	www.turizmi.gov.al	Spektori i Transparencës dhe Komunikimit, Koordinator i për informimin; nëpunësi përgjegjës për IT-në;
Përshkrim i procedurave të zgjedhjes, kompetencave të funksionarëve të lartë dhe procedura e ndjekjes për marrjen e vendimeve.	Neni 7/1/d			www.turizmi.gov.al	Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve; nëpunësi përgjegjës për IT-në;
Mekanizmat monitorues; raporte auditit; dokumentet me tregues performance	Neni7/1 / dh			www.turizmi.gov.al	Drejtoria e Auditit, dhe nëpunësi përgjegjës për IT-në;
Buxheti	Neni 7/1/e			www.turizmi.gov.al	Drejtoria e Financës, nëpunësi përgjegjës për IT-në;
Informacion për procedurat e prokurimit.	Neni 7/1/ë			www.turizmi.gov.al	Drejtoria Juridike, e Komunikimit dhe Prokurimeve, Spektori i Prokurimeve, nëpunësi përgjegjës për IT-në;
Shërbimet për publikun.	Neni 7/1/f			www.turizmi.gov.al	Drejtoritë Teknike, Agjencia Kombëtare

					<i>e Mjedisit, Koordinatori dhe nënpunësi përgjegjës për IT-në;</i>
Paraqitja e mendimeve në hartimin e p/akteve, etj.	Neni 7/1/gj			www.turizmi.gov.al	<i>Drejtoria që propozon projekt-aktin, Pika Fokale e Aarhusit; dhe nënpunësi përgjegjës për IT-në;</i>
Mbajtja e dokumentacionit nga MM	Neni 7/1/h			www.turizmi.gov.al	<i>Nëpunësi përgjegjës për IT-në; Arkivë-Protokolli, Sektori i Transparencës dhe Komunikimit, Koordinatori;</i>
Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve, sipas nenit 8 të këtij ligjit nr.119/2014.	Neni 7/1/i			www.turizmi.gov.al/transparenc	<i>Arkivë-Protokolli, Sektori i Transparencës dhe Komunikimit, Koordinatori;</i>
Informacione dhe dokumente që kërkohen shpesh.	Neni 7/1/k			www.turizmi.gov.al	<i>Koordinatori për informimin</i>
Informacione të tjera të dobishme	Neni 7/1/l			www.turizmi.gov.al	<i>Koordinatori për informimin</i>

V. PUBLIKIMI

Në përputhje me këtë program transparence të miratuar, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit vendos në dispozicion të publikut në faqen e tij të internetit www.turizmi.gov.al dhe në mjediset

e pritjes së publikut, kategoritë e mësipërme, në një menu të veçantë të titulluar “Programi i Transparencës”.

VI. MONITORIMI

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale monitoron zbatimin e ligjit për të drejtën e informimit, duke nxitur parimin e transparencës në punën e autoriteteve publike, veçanërisht duke sensibilizuar dhe informuar për çështje të së drejtës së informimit.

Komisioneri bën rekomandime për autoritetet publike, lidhur me konceptimin dhe zbatimin e programeve institucionale të transparencës.